



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:127307

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05448445

KA.nr.412/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I.N.-Ndërrmarrja Nikci Trans Sh.P.K. me NUI 601607560 dhe seli në fshati Shtypeq i Madh në Pejë, kundër të paditurit Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me seli në rrugën “Luan Haradinaj” ish pallati i mediave “Rilindja” kati XV/04 në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit administrativ, jashtë seancës, më 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia e paditësit I.N.-Ndërrmarrja Nikci Trans Sh.P.K. me NUI 601607560, për anulimin e vendimit nr. ref. 100/AMMK/2020 të datës 03.07.2020 dhe vendimit Ref.100/AMMK/2020 i datës 02.09.2020, së të paditurit Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.

A R S Y E T I M

Paditësi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative më 05.10.2020 kishte iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr. ref.100/AMMK/2020 të datës 03.07.2020 dhe vendimit ref.100/AMMK/2020 të datës 02.09.2020 së të paditurit Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, organ administrativ në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Gjykata Themelore në Prishtinë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kishte konstatuar se padia është jo e plotë ngase nuk është e nënshkruar nga Paditësi, andaj më 21.10.2020 përmes aktvendimit A.nr. 1637/20 vendosi që padinë t’ia kthejë Paditësit në plotësim duke e paralajmëruar atë se nëse nuk i mënjanon të metat e padisë brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, gjykata do ta hedhë poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 të LKA-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative konstaton se Paditësi më datë 29.10.2020 e ka pranuar aktvendimin A.nr.1637/20 të datës 21.10.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa nuk ka vepruar sipas këtij aktvendimit. Sipas nenit 33 para. 2 të LKA-së *“Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.”*

Edhe pse Paditësit më 01.03.2021 përmes parashtrësës kishte dorëzuar prova në Gjykatën Themelore në Prishtinë, megjithatë ai nuk kishte e kishte dorëzuar padinë e tij të nënshkruar, sipas udhëzimeve të gjykatës. Prandaj gjykata e pati juridikisht të pamundshme që të pranoj atë parashtrësë si korrigjim të padisë, gjegjësisht si dorëzim të padisë si të nënshkruar. Përveç kësaj, ajo parashtrësë ishte dorëzuar gati 5 muaj pasi Paditësi e kishte pranuar aktvendimin, me të cilin ishte fuar që t’i evitoj të metat e gjetura në padi.

Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës të caktuara në aktvendimin për korrigjimin e padisë, ndonëse ishte i paraprlajmëruar për pasojat, atëherë gjykata në bazë të nenit 33 para. 2 të LKA-së vendosi si në dispozitiv të këtij atkvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.412/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.